

20160391008

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E**  
**LIGJIT PËR MBROJTJEN E TRASHIGIMISË KULTURORE**

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër. 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 44/14, 199/14, 104/15, 154/15 dhe 192/15), në nenin 34 në paragrafin (2) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative".

Neni 2

Në nenin 39 në paragrafin (2) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në afat prej 15 ditësh nga pranimi i propozimit".

Në paragrafin (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Kundër aktvendimit për mbrojtje të përkohshme mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit".

Paragrafi (5) bëhet paragraf (6).

Neni 3

Në nenin 40 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit".

Paragrafët (3), (4) dhe (5) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6)

Neni 4

Në nenin 42-a në paragrafin (2) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në afat prej tetë ditësh nga pranimi i kërkesës".

Në paragrafin (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit".

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Neni 5

Në nenin 43 në paragrafin (2) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në afat prej tetë ditësh nga pranimi i kërkesës".

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit".

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

Neni 6

Në nenin 45 në paragrafin (5) pas fjalës "Drejtoria" pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "që mbahet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative".

Neni 7

Në nenin 55 pas paragrafit (8) pas fjalës "ankesë" shtohen fjalët: "në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi te lejes respektivisht aktvendimit".

Neni 8

Neni 55-a shlyhet.

Neni 9

Në nenin 60 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Për aktvendimin nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 10

Në nenin 61 në paragrafin (5) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në afat prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e kryerjes së gërmimeve arkeologjike."

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Për aktvendimin nga paragrafi (1), (3) dhe (4) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit."

Paragrafi (6) bëhet paragraf (7).

Neni 11

Në nenin 63 në paragrafin (2) fjala "ministri" zëvendësohen me fjalën "Ministria".

Neni 12

Neni 63-a shlyhet.

Neni 13

Në nenin 67 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Për aktvendimin nga paragrafi (1) pika 1 dhe 2 dhe paragrafi (2) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit."

Paragrafët (6) dhe (7) bëhen paragrafë (7) dhe (8).

Neni 14

Në nenin 74 në paragrafin (4) fjalët: "furnizojë nga Drejtoria kushte mbrojtëse konservative" zëvendësohen me fjalët: "dorëzojë kërkesë te Drejtoria për lëshimin e kushteve mbrojtëse konservative".

Pas paragrafit (4) shtohen dy paragrafë të rinj (5) dhe (6) si vijon:

"(5) Pas kërkesës së palës për lëshimin e kushteve mbrojtëse konservative, institucioni kompetent publik për mbrojtjen e të njëjtave i përpilon në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, ndërsa Drejtoria e miraton aktvendimin për lëshimin e kushteve mbrojtëse konservative në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(6) për aktvendimin nga paragrafi (5) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit."

Paragrafi (5) bëhet paragraf (7).

Pas paragrafit (6) i cili bëhet paragrafi (8) shtohet paragraf i ri (9) si vijon:

"(9) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (4) të këtij neni i përcakton ministri i kulturës."

Neni 15

Neni 75-a shlyhet.

Neni 16

Në nenin 75-b në paragrafin (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Kundër mendimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të mendimit."

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

#### Neni 17

Në nenin 80 pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijon:

"(3) Drejtoria lëshon leje paraprake në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Kundër lejes nga paragrafi (3) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të lejes."

#### Neni 18

Në nenin 82 pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7) si vijon:

"(6) Drejtoria e lëshon lejen nga paragrafi (3) i këtij neni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës për leje.

(7) Kundër lejes nga paragrafi (6) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të lejes."

Paragrafët (6), (7) dhe (8) bëhen paragrafë (8), (9) dhe (10)

#### Neni 19

Në nenin 83 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Për aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit."

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

#### Neni 20

Në nenin 87 pas paragrafit (11) shtohet paragraf i ri (12), si vijon:

"(12) Kundër lejes konservatore nga paragrafi (4) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të lejes konservatore."

#### Neni 21

Neni 87-a shlyhet.

#### Neni 22

Në nenin 88 në paragrafin (1) në pikën 1. numri "153" zëvendësohet me numrin "155".

#### Neni 23

Në nenin 90 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Për aktvendimin nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit."

Paragrafi (5) bëhet paragraf (6).

#### Neni 24

Në nenin 130 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Kundër aktvendimit nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit."

Paragrafi (5) bëhet paragraf (6).

#### Neni 25

Në nenin 133 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) për aktvendimin nga paragrafi (5) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit."

Paragrafët (6) dhe (7) bëhen paragrafë (7) dhe (8).

#### Neni 26

Në nenin 139 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Për aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

#### Neni 27

Në nenin 144-a paragrafi (4) në alinenë 5 pas fjalës "kaluar" pikëpresja zëvendësohen me lidhëzën "ose", ndërsa pas fjalëve: "60 pikë" fjalët: "ose APTIS - të paktën niveli B2" zëvendësohen me lidhëzën "dhe".

#### Neni 28

Në nenin 145 paragrafi (3) ndryshon si vijon:

"(3) Kundër akteve të cilat i miraton Drejtoria në pajtim me këtë ligj, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, te Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë. Ankesa nuk e prolongon zbatimin."

#### Neni 29

Në nenin 166 pas fjalës "provim" vendoset presje dhe shtohen fjalët: "forma dhe përmbajtja e formularëve të kërkesave për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në tituj profesional, mënyra e dhënies së provimit profesional, mënyra e kryerjes së zgjedhjes respektivisht rizgjedhjes, në titujt profesionalë".

#### Neni 30

Në nenin 172 paragrafi (1) pika 4 fjalët: "75-a" zëvendësohen me fjalët: "75-b".

#### Neni 31

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 32

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

#### Neni 33

Dispozitat nga nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 28 dhe 29 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

#### Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".